REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 1124/20
Datë/Datum. 21.12.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **N.P.L PASTRIMI SH.A**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **NPL-20-7413-1-2-1**

Sa i përket tenderit për: **FURNIZIM ME KAMION PER MBETURINA**

A N K E S Ë

1. Identifikimi i ankuesit*

DIELLI CONSTRUCTION & EQUIPMENT SH.P.K
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

MAGJISTRALJA ; FERIZAJ – PRISHTINE , F.SH PRELEZ I JERLIVE
(Adresa)

FERIZAJ *(Vendi)* **70000** *(Kodi postar)*

045 944 289 *(Numri Telefonit)* _____ *(Numri i Faks-it)*

RAGIP ZEJNA
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

amirzejna@live.com
(Adresa elektronike)

SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR SH.P.K. DIELLI CONSTRUCTION & EQUIPMENT FERIZAJ

21.12.2020

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të kërkesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Ky aktivitet i prokurimit ka filluar me njoftimin për kontrate me datë 10.11.2020 Hapja publike është bërë më datë: 20.11.2020 Njoftimi për vendimin e AK-se është bërë me datë 02.12.2020. Te pakënaqur me këtë vendim dhe ne afat te rregullte kohore kemi parashtruar pranë AK-së Kërkesë për Rishqyrtim. AK me datë 11.12.2020 ka publikuar një vendim mbi refuzimin e kërkesës tonë si të pabazuar. Të pakënaqur me këtë vendim po i drejtohemi OSHP-së me këtë ankesë kundër vendimeve të AK-së Kriter vlerësimi është tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Hapja publike është bërë më datë: 20.11.2020

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] **Jo** [ ]

Te pakënaqur me këtë vendim dhe ne afat te rregullte kohore kemi parashtruar pranë AK-së Kërkesë për Rishqyrtim.

AK me datë 11.12.2020 ka publikuar një vendim mbi refuzimin e kërkesës tonë si të pabazuar. Të pakënaqur me këtë vendim po i drejtohemi OSHP-së me këtë ankesë kundër vendimeve të AK-së

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK ka shkelur nenin 7 të LPP Nr. 04/L-042!

AK ka shkelur nenin 10 të LPP Nr. 04/L-042!

AK ka shkelur nenin 6 të RRUOPP-së!

AK ka shkelur nenin 13 të LPP Nr. 04/L-042!

AK ka shkelur nenin 56 të LPP Nr. 04/L-042!

AK ka shkelur nenin 60 të LPP Nr. 04/L-042!

AK ka shkelur nenin 69 të LPP Nr. 04/L-042!

AK ka shkelur nenin 72 të LPP Nr. 04/L-042!

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Pretendimi 1. AK ka shkelur nenin 7 të LPP pasi që së pari nuk na ka dhënë qasje në dosjen e tenderit duke e zvarritur atë deri 1 orë para skadimit për parashtrim të kërkesës për rishqyrtim. Ne kemi kërkuar menjëherë me datë 03.12.2020 që të na lejohet qasja një dokumentet e tenderit mirëpo AK tek ditën e fundit pas insistimit edhe nga ana e KRPP na ka ofruar qasje në ora 15.00 por nuk është paraqiturnë zyre deri pak para orës 16. Ne kemi dyshuar se AK po fsheh diçka nga ne pasi që nuk ka dha qasje me kohe andaj edhe kemi insistuar në qasje. Ne kemi marr informata që ky OE nuk plotëson një mori kërkesash të dosjes së tenderit dhe si i tillë është dashur të konsiderohet i papërgjegjshëm. AK nuk ka bërë fare trajtim të barabartë pasi që ka shpërblyer një OE të papërgjegjshëm ndërsa neve na eliminon edhe pse i kemi të gjitha dëshmitë sipas dosjes së tenderit. AK na diskriminon edhe me rastin e mos dhënies së qasjes në dokumente të tenderit me kohë andaj me plot kuptim mund të themi se AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së. Mangësitë e OE të shpallur fitues i gjeni tek pretendimi 4 në vazhdim.

Pretendimi 2. AK ka shkelur nenin 10 të LPP-së pasi që nuk na ka dhënë me kohë asnjë në dokumentacionin e tenderit edhe pse e ka bërë publikimin e njoftimit për vendimin e AK. Nenin 10 i LPP shumë qartë e obligon AK që me rastin e kërkesave për qasje, atë ta lejon me njëherë dhe pa kufizim. AK nuk e ka respektuar këtë nen pasi që prej datë 03 12.2020 jemi duke pritur që të na lejohet qasja dhe vetëm me datë 07.12.2020 në ora 15.00 na është dhënë një mundësi e tillë. Edhe përkundër kësaj Zyrtari Kryesor i Prokurimit nuk ka ardhur deri pak minutave para orës 16.00 dhe si pasoj e kësaj kërkesën për rishqyrtim e kemi paraqitur pa pasur faktet e nevojshme për shkelje. Ne momentin kur ka ardhur në zyre ZKP ka pasur një qasje shumë të pahijshme duke bërtitur dhe duke u sjellur aspak në mënyrë syrtare siq e ka të obliguar me kodin e etikës dhe me nenin 10 të LPP-së. Mos dhënja e qasjes në dokumntacionin e tenderit me kohë, konsiderohet dhunim i transparencës dhe shkelje e plotë e nenit 10 të LPP-së.

Shiko kërkesën për qasje në dokumente dhe përgjigja e tyre:

amir zejna
Thu 12/3/2020 9:03 AM
To: NPL PASTRIMI SHA
Te nderuar ,
Sipas ligjit te Prokurimit Publik , neni 10 kërkojm të na mundësoni në afat sa më të shkurtër
qasje në dokumentacionin të Operatorit Ekonomik të shpallur nga AK Fitues si dhe marrjen e
dokumentacionit të nevojshem për OE (kopje), për tederin me titutll ;
Furnizim me Kamion për Mbeturina .

Ju lutem na informoni për datën dhe kohën e ardhjes .

Ju faliminderit për mirëkuptimin tuaj , ju lutem na konfirmoni emailin e pranuar .
Siqerisht ,

NPL PASTRIMI SHA 08:31
To You

Pershendetje te nderuar uroj te jeni mire
Po ju shkruajm lidhur me kerkesen tuaj per qasje ne dokumentet e OE,.se propozuiar si fituese per proceduren "**Furnizim me kamion per mbeturina**" ,ju njoftoj se sot rreth ores 15:00 mund te vini per qasje ne dokumentacionin e kerkuar sepse jam duke udhetuar ne Prishtine ne nje trajnim keshtu qe sot mund te vini ne oren qe ua shënuam me herët.

Me Respekt e pune të mbarë çdo te mirë

NPL.'Pastrimi"SH.A.
Tel. mob. 044 472 042
Rruga "Dëshmorët e Kombit' Hani i Elezit

Pavarsisht kësaj ZKP u vonua për në takim dhe mendojmë se e ka bërë qellimisht vetëm sa për të na e ikur afatin për parashtrim Kërkese për Rishqyrtim. Bazuar në sjelljen arrogante dhe të pahijshme na bind se kjo ka qenë e qëllimshme. Përpos kësaj ne kemi marr 11 dokumente, dmth 11 faqe të formatit AK dhe ky pale zyrtar na ka detyruar të paguajmë nga 2 euro për faqe si kosto për shpenzime të fotokopjimit që në total i bi se kemi paguar për 11 faqe – 22 euro. Ky çmim për printim nuk ekziston në asnjë vend të botës dhe kjo tregon shumë qartë korrektësin dhe sjelljen prej e tijë karrshi neve. Veprimi i tillë bie ndesh me nenin 6 të RRUOPP-së i cili shumë qartë e tregon se deri në 20 faqe janë pa pagese ndëra mbi njëzet faqe paguhen me një çmim sa për të mbuluar koston e printimit. Ne kemi shikuar kontratën Kontratën për pajisje fotokopjuese dhe toner për printim si dhe për fleta të bardha dhe pas analizës del që një faqe komunës i kushton më pak se 0.01 €.

Ja si e përshkruan rregullorja këtë çështje:

7.4 Përveç dokumenteve të klasifikuara si informata sekrete të biznesit, AK do ti ofroj, çdo pale te interesuar që bënë kërkesë, qasje të shpejtë dhe të arsyeshme në të gjitha të dhënat për aktivitetin e prokurimit. Pala e interesuar në fjalë do të ketë qasje në dokumente duke konsultuar ato në zyrën e prokurimit. Konsultimi në zyrën e prokurimit, nëse bëhet fjalë për më pak se 20 faqe A4 dhe qasje direkte të formës elektronike do të jenë të liruara nga tarifa.

Bazuar në këtë shihet se ky zyrtar neve na ka plaçkitur sa i përket detyrimit të pagimit për 11 faqe format AK në vlerë prej 22 euro. Kjo është një shkelje e parimeve bazë të prokurimit por edhe shkelje e etikës së një zyrtari në pozitën e tillë të punës. Shihe dëshminë e pagesës

dhe procesverbalin lidhur me dokumentet e marrura:

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA -HANI I ELEZIT / OPŠTINA HANI I ELEZIT / MUNICIPALITY OF HANI I ELEZIT
DREJTORIA PËR FINANCA EKONOMI DHE DHE ZHVILLIM
DIREKCIJA ZA FINANCIJE PRIVREDU I RAZVOJ
DEPARTMENT OF FINANCE ECONOMY AND DEVELOPMENT

TAKSË PËR PJESËMARRJE NË TENDER / TAKSA ZA UČEŠĆE U TENDER / TENDER PARTICIPATION FEE

FATURË RAČUN INVOICE
Nr.Ser / Ser.br / Ser.no № 000206

Emri / Mbiemri / Ime / Prezime / Name / Surname: OE Drelli construction & Equipment
Përshkrimi / Opis / Description: Dokumenta me faqe 11 fletë
Shuma / Iznos / Amount: € 30,00
Me fjalë / Riječima / In words: Njëzetë euro
Llogaria bankare / Broj žiroračuna / Bank account: 1000650080000043
Lëshuar nga / Izdato od / Issued by:
Nënshkrimi dhe vula e bankës / potpis i pečat banke / bank signature and stamp
UNIREF
HEB4Z111111111L

Procesverbali i qasjes në Tenderin „Furnizim me kancelar për mbeturina"
Dt. qasjes 04.12.2020
Dokumentet që i ka kërkuar
1. Deklarata për besueshmëri
2. Certifikatat ISO (9001 & 14001)
3. Listën e kontratave të realizuara
4. Specifikimi teknik
5. Referencat

Emir Zejna
OE. Drelli Construction & Equipment

Avdullah Bajramaliu
Zyrtari i Prokurimit

Bazuar në krejt këtë shihet se AK ka shkelur nenin 10 të LPP-[së dhe ka shkelur edhe nenin 6 të RRUOPP-së që flet për Informacione Sekrete të Biznesit dhe Qasja në Dokumentacion.

Pretendimi 3. AK ka shkelur nenin 56 të LPP-së pasi që OE i shpallur fitues nuk është i përgjegjshëm. I mungojnë ISO certifikatat e noterizuara, nuk ka ofruar fare deklaratën lidhur me specifikimet teknike, i mungon certifikata e origjines se artikullit si dhe mangësi tjera. Ne pretendojmë se ky OE është i papërgjegjshëm dhe se AK nuk ka vlerësuar sipas pikës 1 të

këtij neni i cili kërkon që AK së pari të i vlersoj tenderët për nga përgjegjshmëria e më oas për nga kriteri i vlerësimit. Bazuar në këtë AK nuk ka vepruar fare sipas kësaj dhe ka shkelur nenin 56 .1 të LPP-së.

Pretendimi 4. AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së me rastin e vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. AK nuk ka respektuar nenin 59.4 të LPP i cili thotë se OE për të qenë i përgjegjshëm duhet të plotësoj të gjitha kriteret e dosjes së tenderit. AK kishte kërkuar që OE të dorëzojnë:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional** **Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme, në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë min. 111,000.00 €uro.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Lista e projekteve te kryera në lëmin e furnizimeve të ngjashme të realizuar në tri vitet e fundit, nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, duke saktësuar Titujt e projekteve, shumën e kontratës, numrin e Prokurimit, data e kontraktimit – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik, DHE dëshmitë e përfundimit, Referencat ose Pranimtt teknike për furnizime të kryera në lëmin e furnizimeve të ngjashme.**

O E i shpallur fitues nuk ka asnjë projekt të realizuar nga natyra e ngjashme me projektin e AK-së pasi që të gjitha janë për pajisje bujqësore si kultivatora, mekanizma për mbjellje të grurit etj. Dhe asnjë projekt të vetëm nuk e ka për furnizim me kamion për grumbullimin e mbeturinave. Shihi listen e kontratave dhe referencat e ketoj OE te bashkangjitura ankeses tonë. Kjo konsiderohet mangësi dhe si pasoj ky OE do duheje të shpallej i papërgjegjshëm. Kërkesa tjetër ka qenë që:

Specifikacionet teknike të detyrueshme	3.1	Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet dëshmuese për qëllimin e ofruar të kontratës, duke përfshirë: a. Deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit.

Ky OE nuk e ka ofruar fare këtë deklaratë e cila ka qenë mandatore për t'u kualifikuar si i përgjegjshëm. Në mungesë të kësaj deklarate ky OE konsiderohet i papërgjegjshëm.

AK ka kërkuar edhe dëshmi lidhur me ISO certifikatat:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale		**Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me keto Certifikata EN–ISO 9001-2015 (Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë); EN–ISO 14001-2015 (Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit)**	**Kopje e noterizuar nga orgjinali te jetë valide**

Ky OE ka ofruar dy certifikata ISO të **pa-noterizuara** dhe atë në kopje bardh e zi të cilat si dëshmi nuk e plotësojnë kërkesën e AK as për së afërmi dhe për mangësi të tillë konsiderohet

OE i papërgjegjshëm. Përpos kësaj njëra ISO certifikatë është në gjuhën gjermane ku sipas nenit 13 të LPP nuk mundet të pranohet si dëshmi sepse të gjitha dokumentet mbështetëse duhet të jenë në gjuhën shqipe, serbe apo angleze. Mangësi tjetër është se ISO certifikatat janë vetëm për mekanizma dhe pajisje bujqësore dhe nuk e mbulon pjesën për pajisje dhe makineri për grumbullimin e mbeturinave të cilat janë të një standardi krejt tjetër. Shihe certifikatën si duket, ku mundeni ti vërtetoni pretendimet tona lidhur mangësitë e sajë: por e gjeni edhe të bashkangjitur ankesës tonë:

TÜV NORD

ZERTIFIKAT

für das Managementsystem nach
ISO 9001 : 2015

Die Zertifizierungsstelle TÜV NORD CERT GmbH bestätigt hiermit als Ergebnis der Auditierung, Bewertung und Zertifizierungsentscheidung gemäß ISO/IEC 17021-1:2015, dass der Kunde

N.P.T HAXHIJAHA Sh.p.k
Xhelal Hajda p.n.
21000 Rahovec
Kosovo

Haxhijaha

ein Managementsystem konform zu den Anforderungen der ISO 9001 : 2015 betreibt und innerhalb der Laufzeit des Zertifikats von 3 Jahren auf Konformität überwacht wird.

Geltungsbereich

Großhandel mit landwirtschaftlichen Maschinen, Ausrüstungen und Zubehör

Zertifikat-Registrier-Nr. 44 100 20 32 0170
Auditbericht-Nr. 35600 1289

Gültig von 2020-09-01
Gültig bis 2023-08-31
Erstzertifizierung 2020

Zertifizierungsstelle
der TÜV NORD CERT GmbH

Plovdiv, 2020-09-01

TÜV NORD CERT GmbH Langemarckstraße 20 45141 Essen www.tuev-nord-cert.de

IAF DAkkS Deutsche Akkreditierungsstelle D-ZM-12051-01-09

Tek specifikimi teknik që AK e ka vendosur tek lista e çmimeve e jo tek Aneksi 1, AK ka kërkuar që kapaciteti i komparaatorit të jetë **7+1 m³.** Shihe tabelën në vazhdim:

KAMION PËR BARTJEN E MBETURINA

No.	Pershkrimi	Detajet teknike	Njesia	Sasia	çmimi	Totali
1	Tipi I automjetit	Kamion per mbeturina				
2	Viti i prodhimit	2020				
3	Motori	DIESEL, Euro 6D				
4	Kapaciteti I motorit	Minimum 5193 CC				
5	Fuqia e motorit	Minimum 140KW/190 HP				
6	Transmisioni	MANUAL				
7	Kapaciteti I udhetareve	Vozitesi + 2 udhetare				
8	Boshti I rrotave	Minimum 3365 mm				
9	Konfigurimi I boshtit	4x2				
10	Limiti I peshes I kamionit	Minimum 9800kg				
11	Rezervoari I naftes	Minimum 100 litra	cope	1		
12	Rezervoari I ADBlue	Minimum 16.5 litra				
13	Madhesia e gomave te perparme	Minimum 225/75R17,5				
14	Madhesia e gomave te mbrapme	Minimum 215/75R17,5				
15	Zingjir per goma 4 palë					
16	Kapaciteti I kompaktorit	7+1M3				
17	Dyshemeja e kompaktorit	Minimum Trashesia 4mm				
18	Muret dhe tavani i kompaktorit	Minimum Trashesia 4mm				

Ndërsa OE i shpallur fitues nuk e ka plotësuar këtë kriter pasi që kapaciteti i komparatorit që ka ofruar është vetëm **7 m³.** Shihe dëshminë:

HIDRO-MAK

TECHNICAL SPECIFICATIONS FOR GARBAGE COMPACTORS

NO	PARAMETER	SPECIFICATIONS
1.	Body	Hidro-Mak Brand Rear Loading Hydraulic Garbage Compactor
	Code No.	SCK-7
	General Info	Body up-fit consists of a body and its sub-frame mounted on a truck chassis, a tailgate with compaction mechanism, discharging/ejection plate inside the body, bin lifter device ,hydraulic and electrical components and their installation on garbage compactor.
	Capacity (m³)	7 m³ excluding tailgate(hopper)
	Body Floor	St-52 (S355J2) / 4mm brown coloured area in below figure 
	Body Sides	St-52 / 4 mm. Body side walls are smooth type and convex shaped without any vertical profile/ribs and traverses on side walls (like in sample drawing)
	Body Roof	St-52 (S355J2) / 4 mm.
	Sub-frame	St-52 (S355J2) / 6 mm.

Bazuar në këtë shihet se ky OE nuk e plotëson as specifikimin teknik të kërkuar nga AK dh epër këtë konsiderohet OE i papërgjegjshëm.

Përpos këtyra AK ka kërkuar edhe:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale		**Produktet duhet të jenë të prodhuara nga ndonjë vend anëtar ose kandidat për antarësim në BE**	**Certifikata e origjinës së produkteve së bashku me katalogjet për pajisjen e ofruar duke përfshirë këtu edhe përshkrimin teknik të pajisjes së ofruar dhe origjinën e pajisjeve të cilat duhen të jenë të prodhuara në një vend të BE-së ose shtet kandidat për anëtarësim në BE, duhet të dorëzohet në (origjinal ose kopje e dukshme)**

Ky OE nuk ak ofruar fare dëshminë – çertifikatën e origjinës së produkteve ashtu siç është kërkuar dhe mungesa e sajë në ofertën e tijë këtë OE e bënë të papërgjegjshëm plotësisht.
Krejt këto mangësi mundeni ti gjeni të bashkangjitur tek dëshmit e dorësuara së bashku me ankesën tonë.
Nisur nga ky fakt del se OE i shpallur fitues nuk është fare i përgjegjshëm dhe se AK ka shkelur plotësisht nenin 59.4 të LPP i cili është baza dh shtylla kryesore e një vlersimi real dhe duke u bazuar vetëm në kriteret dhe kërkesat epërcaktuara paraprakisht në dosjen e tenderit.

Pretendimi 5. AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së pasi që nuk ka vlerësuar sipas kriterit të paraparë me këtë nen. Kriteri i tillë thotë se së pari OE duhet të jet i përgjegjshëm e më pas të ketë edhe çmimin më të ulët. OE i shpallur fitues e ka çmimin për shumë pak më të ulët se ne mirëpo ka mangësi në ofertën e tij që e bëjnë të papërgjegjshëm. Nga kjo konkludojmë se AK ka shkelur edhe nenin 60 të LPP-së.

Pretendimi 6. AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit nuk është siguruar se OE i shpallur fitues është i përgjegjshëm sipas këtij nenin. AK nuk ka respektuar as kriteret e vendosura nga vet ai në dosjen e tenderit që lidhen me kërkesat e nenit 69 siç janë ISO certifikatat dhe dëshmi tjera, prandaj mendojmë se AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së.

Pretendimi 7. AK ka shkelur nenin 72 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit edhe pse ka vërejtur mangësi në ofertën e OE që e ka shpallur fitues, nuk e ka sqaruar fare sipas nenit 72. Kjo konsiderohet gabim sepse kur diçka nuk është sipas dosjes s tenderit, duhet sqaruar e jp pranuar ashtu me mangësi dhe pa informata të mjaftueshme. ISO certifikata mungojnë andaj AK nuk i ka sqaruar dhe mendojmë se ka shkelur plotësisht nenin 72 të LPP-së.

Nisur nga gjendja faktike dhe nisur edhe nga ato që thamë me lartë, kërkojmë nga OSHP që të marr:

V E N D I M

APROHOHET si e bazuar ankesa e OE **"DIELLI CONSTRUCTION & EQUIPMENT SHPK"** lidhur me tenderin **"FURNIZIM ME KAMION PER MBETURINA"** i iniciuar nga **N.P.L PASTRIMI SH.A**

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK- **N.P.L PASTRIMI SH.A** për dhënie të kontratës **NPT."HAXHIJAHA"SH.P.K.** dhe lënda të kthehet në **ri-vlerësim.**

AK të bëjë **Ri-vlerësimin** bazuar plotësisht në kërkesat e dosjes së tenderit që realisht më pas do duhej te shpallej **FITUES** kompania jone **"DIELLI CONSTRUCTION & EQUIPMENT"shpk.** si kompania me çmimin më të ulët.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Mosdhënia e mundësisë për tenderim, rrezikon të na shkaktoj dëme materiale për vlerën e fitimit te munguar dhe shpenzimet e përgatitjes se tenderit njëkohësisht do të bëjë dëmtimin e reputacionit si njëra ndër kompanitë më të njohura për shitjen e këtyre artikujve.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- 1 B05 Njoftim per Kontrat
- 2 Template per Dosja e Tenderit Kamioni ALB.
- 3 Specifikimi i Kamioni per mbeturina 2020 -per dosje
- 4 Procesverbnali i hapjes- Furnizim me kamion te mbeturinave
- 5 NJOFTIM PER VENDIMIN E AK - Furnizim ME KAMION
- 6 Mail - amir zejna - emaili i derguar per qasje
- 6.1 KERKESE PER RISHQYRTIM 07.12.2020
- 7 PROCESVERBALI I MARRJES SE DOCUMENTEVE
- 8 DESHMIA E PAGESES SE FLETEVE
- 9 Pergjigjja ne kerkesen per qasnje nga AK
- 9.1 Vendim mbi Kerkesen per Rishqyrtim
- 10 ISO 9001_2015 E PA NOTERIZUAR
- 11 ISO 14001_2015 E PA NOTERIZUAR DHE JO ADEKUATE PER VEPRIMTARIN
- 12 LISTA E KONTRATAVE TE REALIZUARA 1
- 13 LISTA E KONTRATAVE TE REALIZUARA 2
- 14 LISTA E KONTRATAVE TE REALIZUARA 3
- 15 LISTA E KONTRATAVE TE REALIZUARA 4
- 16 REFERENCA 1
- 17 REFERENCA 2
- 18 REFERENCA 3
- 19 REFERENCA 4
- 20 SPECIFIKIMI TEKNIK I MBINDERTIMIT 7 M3 nha Haxhijaha